



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1764/1 Prot.

Tiranë, më 02.12 2020

V E N D I M

Nr. 49 dt. 02.12 2020

**MBI MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE DHE ANALITIKE DHE TË NUMRIT TË PERSONELIT AKADEMIK ME KOHË TË FTUAR PËR FVFR.**

Mbështetur në Ligjin nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, në vijim të Vendimit të Bordit të Administrimit nr.10, dt.04.02.2020 “Mbi miratimin e strukturës organizative dhe analitike, dhe klasifikimit të pagës për vitin 2020”, i ndryshuar, në shkresën e Dekanatit të FVFR me nr.1743, datë.25.11.2020 “Kërkesë për personel të ftuar pranë FVFR”, shkresën e IKSHS nr. 1705 datë 18.11.2020 ”Kërkesë për miratim të ndryshimeve në strukturën organike dhe analitike të IKSHS”, në Vendimin e Senati nr. 45 datë 27.11.2020 “Mbi disa ndryshime në strukturën organizative dhe analitike të Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe miratimin e numrit të personelit akademik të ftuar në FVFR”, Bordi i Administrimit ,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në strukturën organizative e analitike, të Universitetit të Sporteve të Tiranës, sipas tabelës bashkangjitur.
2. Miratimin e 5 (pesë) punonjësve, personel akademik të ftuar pranë FVFR, për trajnimin, kualifikimin dhe çertifikimin e Udhërrëfyesit Turistik të Specialitetit të Veçantë.
3. Efektet financiare për ndryshimin në strukturë të IKSHS, fillojnë me dt.16.11.2020.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Fakulteti i Shkencave të Levizjes, Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, IKSHS, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkivës, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë publikohet në [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) dhe tek trasparenca universitare.

**KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

Hysen Domi



Ndryshimet në strukturën organizative dhe analitike , në UST

Nr.	Njësia	Kategoria	Sipas strukturës ishte	Behet
1	<b>FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES</b>			
1.1		Personel akademik	Profesor (Dep. Mjekësisë Sportive)	Lektor (Dep. Mjekësisë Sportive)
2.	<b>INSTITUTI I KËRKIMIT SHKENCOR TË SPORTIT</b>			
2.1		Personel akademik	Lektor (Dep. Kër. Vepr. Shënd. Rekreacionit, IKSHS)	Profesor i Asociuar (Dep. Kër. Vepr. Shënd. Rekreacionit, IKSHS)

